



Pranuar / Dorezuar / Prilapsur / Prilato / Received / Delivered	12.04.2021	1	viti / god / year
Organ / Rrjeta / Organ / Zjednicja / Org. / Rbust	SKDMSHEK	1723/2021	1/6
№ Prift / Pr. / Pr. No.		Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.190/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.3053/19 të datës 05.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, te pranuar me date 25.03.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.631/2019 të datës 17.10.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Faik Rexha", nr. 16 në Komunën e Ferizajt, kundër Vendimit me Nr.KZKA 2170 të datës 18.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si pabazuar ankesa me numër A.nr.631/2019 e datës 17.10.2019, e parashtruar nga ankuesja**
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër 2170 i datës 18.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.**

A r s y e t i m

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka shpallur konkursin me datë 10.07. 2019 për vendin e lirë të punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte" në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë, pas marrjes së autorizimit nga Departamenti i Administrimit të Shërimit Civil/Ministria e Administratës Publike, të datës 04.07.2019.

Ankuesja ka aplikuar për vendin e lirë të punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte" në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë-MZHE, e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit.

Me njoftimin e datës 16.08.2019 Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka shpallur kandidatin e suksesshëm për vendin e lirë të punës “Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte” në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë-MZHE.

Ankuesja e pakënaqur me mos përzgjedhjen e saj për vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte” më datë 06.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, më datë 18.09.2019 ka nxjerr Vendim me numër Nr. KZKA 2170 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër Nr. KZKA 2170 të datës 18.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, më datë 17.10.201 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4889/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.10.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ndërsa Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik më datë 22.10.2019, me shkresat e bashkangjitura të lendes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 21.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 05.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.3053/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 17.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritot ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4889/2019 të datës 17.10.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 09.08.2019 nga ankuesja për ankesën; E-mailin e datës 24.09.2019 nga ankuesja për Arkivi MZHE; Vendimin me Nr.KZKA 2170 të datës 18.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; Njoftimin e datës 18.09.2019 lidhur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për fillimin e rekrutimit e datës 21.06.2019; Formularin-PDP për përshkrimin e detyrave të punës i datës 21.06.2019; Konkursin e shpallur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik më datë 10.07.2019 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte”; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 04.07.2019; Vendimin me Nr. Prot: 1883 i datës 05.08.2019 për themelimin e Komisionit përzgjedhës ad hoc të shërbimit civil; Formularin Form. MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kritereve për përfshirjen

në listën e ngushtë i datës 06.08.2019; Njoftimin për përfundimin e procedurës së rekrutimit dhe rezultatin e testimi i datës 16.08.2019 për ankuesen; Ftesa për testimin e kandidatëve nga përzgjedhja e ngushtë i datës 06.08.2019 për ankuesen dhe kandidatet tjerë; Formularin Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual përfundimtar të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për ankuesen dhe kandidatin Raporti mbi listën e kandidatëve nga përzgjedhja e ngushtë i datës 06.08.2019; Propozim i datës 15.08.2019; Raporti i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 15.08.2019; Formularin Form. MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form. MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 16.08.2019; Lista e kandidatëve të cilët kanë marr pjesë në testin me shkrim; Vendimin e datës 16.08.2019 për aprovimin e rekomandimit nga komisioni përzgjedhës; Testi me shkrim i datës 08.08.2019 i kandidatit Butrim Gjonbalaj dhe ankueses; Kërkesën për punësim e datës 31.07.2019 të ankueses; Diplomën e datës 24.12.2015 për ankuesen; Certifikatën për ankuesen e datës 18.12.2015; Certifikatën e lindjes për ankuesen e datës 30.07.2019; Certifikatën e datës 02.09.2017; Rekomandimin nga Vërtetimin e datës 08.05.2019; Certifikatën nga KEDS; Kërkesën për punësim e datës 12.07.2019 nga Referencë pune nga Viena SH.P.K; Vërtetimin e datës 04.02.2019; Diplomën e datës 11.03.2017 dhe 30.10.2017 nga Universiteti Epoka në Republikën e Shqipërisë për kandidatin Vendimin e datës 06.06.2019 dhe 06.11.2018 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civil i datës 26.04.2019; Certificate nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 21.05.2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 22.10.2019; Njoftimin e datës 21.11.2019 për ankuesen; Aktgjykimin A.nr.3053/19 të datës 05.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore lidhur me njoftimin e datës 16.08.2019 për kandidatin e përzgjedhur për vendin e lirë të punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte" në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë-MZHE e cila pretendon se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës në fushën e inxhinierisë ose ekonomisë në krahasim me kandidatin e përzgjedhur, kandidati i përzgjedhur ka diplomë të pavlefshme dhe po ashtu pretendon se nuk janë zbatuar parimet e shërbimit civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në konkursin e shpallur të datës 10.07.2019 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, për pozitën "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte", kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplomë Universitare në fushën e Inxhinierisë Mekanike, Ndërtimtari dhe Ekonomi,*
- *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale".*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesja, si dhe organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte", e shpallur me datë 10.07.2019 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, është bërë në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është përcaktuar se: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paañsinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës", pasi ka marrë

autorizimin nga Ministria e Administratës Publike DASHC/MAP me datën 04.07.2019 dhe se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë të qëndrueshme lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses kundër përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm të datës 16.08.2019 për pozitën **“Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte”**, është i paqëndrueshëm sepse ankuesja është përfshirë në listën e ngushtë me datë 06.08.2017 dhe Komisioni Përzgjedhës e ka vlerësuar drejtë në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 dhe nenin 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: **“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim:...,1.2. përvojën e punës”, secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes”**.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja i është nënshtruar procedurës së rekrutimit në të gjitha fazat e rekrutimit e cila pas testit me shkrim dhe intervistës me gojë është renditur e dyta (2), duke u bazuar në Formularin Form. MAP-SHCK-10 të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, dhe ka arritur gjithsejtë 66.6% të pikëve të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, kurse kandidati i përzgjedhur është renditur i pari pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë dhe ka arritë gjithsejtë 89.8% të pikëve të përgjithshme, dhe mbi këtë bazë është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se përzgjedhja e kandidatit është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”, “Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”**, mbi bazë të kësaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë arritur numrin më të madh të pikëve në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozitë dhe në bazë të Formulari Form. MAP/SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve ankuesja pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka arritë gjithsejtë 66.6% pikët e përgjithshme, dhe është renditur e dyta (2) në listë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin e ankueses se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës dhe kualifikimit në krahasim me kandidatin e përzgjedhur, ka konstatuar se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse nga dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit për përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës së kandidatit i përzgjedhur i plotëson kriteret e kërkuara të konkursit të datës 10.07.2019 për vendin e punës **“Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte”** sepse në bazë të dëshmitëve kandidati i përzgjedhur, posedon Diplomë Universitare të lëshuar me datë 30.10.2015 nga Universiteti „EPOKA” në Republikën e Shqipërisë me të cilën dëshmohet se ka kryer Fakultetin e Arkitektures dhe Inxhinierise dhe ka marr titullin **“Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi”** dhe e njëjta diplomë është e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës në bazë të Vendimit me numër Ref.Nr:6-30/9 të datës 06.11.2018, si dhe me përvojë të punës sipas Vërtetimit të datës 04.02.2018 me të cilën dëshmohet se nga data 01.10.2015 deri më datë 30.11.2018 ka punuar në kompaninë **“ALPET SH.P.K”** në pozitën **“Inxhinier i Ndërtimitarisë”** po ashtu posedon referencë pune të lëshuar nga **“VIENA**

SH.P.K” me të cilën dëshmohet se nga data 31.12.2018- vazhdon në pozitën “Menaxher i Projekteve, ndërsa ankuesja posedon Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se e me datës 08.12.2015 ka kryer Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe ka marr titullin “Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike”, si dhe me përvojë të punës sipas Vërtetimit të datës 08.05.2019 të lëshuar nga KEDS me të cilën dëshmohet se nga data 15.07.2014 deri më datë 27.01.2019 ka punuar në këtë kompani, andaj si rrjedhojë vlerësimi i aplikacionit të ankueses dhe kandidatit të përzgjedhur është bërë në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafit 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.larsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë”*, kështu që vlerësimi i aplikacionet është bërë në bazë të parimit të meritës pasi që të dy kanë plotësuar kushtet e konkursit dhe kanë përvojën e punës siç kërkohet në konkurs, dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që kandidati i përzgjedhur ka diplomë të pavlefshme, ka konstatuar se edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse në bazë të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht dokumenteve në lëndë kandidati posedon Diplomën e datës 30.10.2015 të lëshuar nga Universiteti „EPOKA” në Republikën e Shqipërisë me të cilën dëshmohet se ka kryer Fakultetin e Arkitektures dhe Inxhinierise dhe ka marr titullin “Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi” dhe e njëjta diplomë është e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës me Vendim me numër Ref.Nr:6-30/9 të datës 06.11.2018, kështu që ankuesja nuk ka mund të provojë pretendimin e saj sepse të gjitha dokumentacionet për këtë kandidat janë të lëshuara nga institucionet kompetente.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të gjitha dëshmive për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitura në dosjen e kandidatit të përzgjedhur dhe të ankueses, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ka vlerësuar drejtë me rastin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën “Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte”, duke u bazuar në nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: *„Merita-veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes”*, sepse në provat e lëndës rezulton se kandidati i përzgjedhur ka përmbushur kriteret e veçanta dhe të përgjithshme të kërkuara në konkursin e shpallur me datë 10.07.2019, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes se kandidatit, për pozitën “Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte”, ka vepruar në pajtim me neni 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimt të kandidatëve”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.KZKA 2170 të datës 18.09.2019, ka vepruar ne pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme



Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke arritur të konstatojë drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.3053/19 të datës 05.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.190/2021

Avdyl BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrinë së Zhvillimit Ekonomisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së